



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR
KËSHILLI DREJTUES NË RTSH

Nr. 852/13 Prot.

Tiranë, më 31.08.2026

VENDIM
NR. 39 DATË 31.08.2026

Në zbatim të nenit 102, të Ligjit nr. 97, datë 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 17 të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 22.12.2016 “Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)”, shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme me nr. 852/12 prot., datë 07.08.2026, me lëndë “Në lidhje me projektin filmik me titullin “Zëra që nuk shuhen”, një cikël i filmave dokumentarë televizivë” si dhe në vijim të procesverbalit të mbledhjes, mbajtur në datë 31.08.2026; nga ku Këshilli Drejtues pas procesit të rregullt të votimit dhe me shumicë votash;

VENDOSI:

1. Të miratojë preventivin financiar të projektit filmik me titullin “Zëra që nuk shuhen”, një cikël i filmave dokumentarë televizivë, i përbërë nga 10 filma dokumentarë televizivë, një prodhim ekskluziv i Radio Televizionit Shqiptar, në vlerën prej 5,000,000 (pesë milionë) lekë, sipas preventivit financiar bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të zbatohet rotacioni i stafit të regjisorëve, në funksion të nevojave, kërkesave dhe specifikave të prodhimeve të RTSH-së.
3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për ndjekjen dhe marrjen e masave administrative e financiare për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI DREJTUES

Z. Fatjon Hoxhalli

Z. Petrit Beci

Z. Enio Civici

Z. Pano Xhixho

Z. Alket Braho

Znj. Zamira Kita

Z. Lorenc Vangjeli

Z. Bujar Kapexhiu

Z. Osman Mula

Znj. Rajmonda Bulku

Z. Robert Budina

Kryetar

Nënkryetar

Anëtar

Anëtar (mungon)

Anëtar (kundër)

Anëtar

Anëtar (mungon)

Anëtar

Anëtar

Anëtar

Anëtar (mungon)